

Vendim nr. 265 datë 12.12.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 12.12.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 45 (A) 2023 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARBEN AHMETAJ, ERJOLA HOXHA**, përfaqësuar nga avokatët Ardian Visha dhe Henrik Ligori, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i urdhrin nr. 42, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimit nr. 00-2023-762, datë 11.05.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Dërgimi i çështjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 42, 43, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 77 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 277 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 277/2020*) për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës, në bashkëpunim”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale, në bashkëpunim”, “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, në bashkëpunim”, të parashikuara nga nenet 245 e 25, 248 e 25, 260 dhe 287, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b” të Kodit Penal (KP). Në themel të procedimit penal ka qenë procedura e lidhjes së kontratës së koncesionit me shoqërinë “AlbtekEnergy” sh.p.k., për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë në vitin 2014, si dhe zbatimi i kësaj kontrate nga shoqëria.

2. Me vendimin e datës 19.09.2022 prokuroria ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. 277/2020 në disa procedime penale të tjera. Një prej procedimeve të ndara është regjistruar me numrin 277/1, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës nga funksionarët e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, për hetimin e procedurave të ndjekura për kalimin për miratim të vendimeve nr. 907, datë 17.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë” dhe nr. 792, datë 09.11.2016 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit shoqërisë “AlbtekEnergy” sh.p.k.”.

3. Në datën 22.02.2023 një gazetar, me pretendimin se ishte në dijeni të fakteve penale lidhur me veprime financiare, fshehje të të ardhurave, si dhe pastrim të parave, ka paraqitur kallëzim penal ndaj deputetit Arben Ahmetaj (*kërkuesi i parë*), i cili kishte mbajtur më parë edhe detyrat e ministrit të Financave dhe të zëvendëskryeministrit. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 30, datë 24.02.2023 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 të KP-së. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022 në një procedim të vetëm që është regjistruar me nr. 277/1, viti 2023 (*procedimi penal nr. 277/1/2023*), për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP-së.

4. Në datën 08.03.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë në gjykatë për kontrollin personal të kërkueses Erjola Hoxha (*kërkuësja e dytë*), e cila, sipas prokurorisë, së bashku me kërkuësin e parë janë prindër të një fëmije. Po ashtu, prokuroria ka kërkuar në gjykatë edhe kontrollin e një shtëpie të kërkueses së dytë, të ndodhur në Hamallaj, Durrës, të blerë me kontratën e datës 31.03.2022. Në paraqitjen e kërkesës në gjykatë prokuroria ka parashtruar se nga kontrollet mund të gjendeshin gjurmë të veprave penale që i shërbenin hetimit për blerjet e pasurive, të tilla si: dokumente, kompjuterë, telefona celularë, shënime të ndryshme, çelësa shtëpie, fotografi, si dhe para *cash*.

5. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), e ka shqyrtuar kërkesën në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve dhe me vendimin nr. 114 akti, datë 08.03.2023 ka vendosur lejimin e kontrollit personal dhe të banesës së kërkueses së dytë nga hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e Policisë Gjyqësore, sipas neneve 203-207 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe garancive të parashikuara në nenet 205 dhe 103 të po këtij kodi. Kjo gjykatë ka arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë konsumuar elementet e figurave të veprave penale, për të cilat është regjistruar procedimi penal dhe se provat materiale mund të jenë fshehur te personat dhe vendet që kërkohej të kontrolloheshin. Në pikën 15 të dispozitivit të vendimit, gjykata është shprehur se kundër vendimit nuk lejohet ankim. Pavarësisht këtij disponimi, të dy kërkuësit, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjorë, kanë paraqitur apel.

6. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), në dhomën e këshillimit, me urdhrin nr. 42, datë 28.03.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se vendimi është i paankimueshëm, pasi KPP-ja nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit që lejon kontrollin e personave dhe të vendeve. Kërkuësit kanë paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00 – 2023 – 762, datë 11.05.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimi i kontrollit është i paankimueshëm dhe se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të neneve 202, 202/a dhe 407 të KPP-së.

8. Në datën 11.09.2023 kërkuësit i janë drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), i cilipas plotësimi, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.09.2023. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuësve

9. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe neni 13 i KEDNJ-së i lidhur me nenin 8 të saj, në aspektet e mëposhtme:

9.1. *E drejta për akses*, pasi argumenti i GJKKO-së së Apelit, i konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë, se vendimi i datës 08.03.2023 është vendim i paankimueshëmka penguar ushtrimin e kësaj të drejte. Rasti konkret nuk gjendet përpara kushteve përjashtimore dhe nuk plotësohet rregulli i proporcionalitetit që vendos neni 17 i Kushtetutës.

9.2. *E drejta për ankim efektiv*, pasi kërkuësve u është kufizuar ankimi para një gjykate më të lartë ndaj vendimit gjyqësor që u ka cenuar të drejtën për liri, siguri, dinjitet, privatësisë së banesës dhe komunikimeve, të garantuara nga nenet 25, 36 dhe 37 të Kushtetutës, si dhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi GJKKO-së së Shkallës së Parë i mungon kompetenca për të vendosur kontrollin e banesës së deputetit (kërkuësit të parë) pa autorizimin e Kuvendit.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

10. Çështja e legjitimitimit (*locusstandi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton

mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me legjitimimin *rationemateriae* të kërkuesit, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

13. Kërkuesit, në thelb të ankimit të tyre kushtetues, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektet e të drejtave të aksesit në gjykatë dhe të ankimit efektiv, të garantuara nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së. Sipas tyre, vendimi për lejimin e kontrolleve është dhënë në gjykatën e shkallës së parë bazuar vetëm në kërkesën e prokurorit dhe gjykatat në interpretim të ligjit kanë nxjerrë përfundimin se vendimi i dhënë është i paankimueshëm. Për rrjedhojë, atyre iu është kufizuar në mënyrë joproporcionale e drejta e kundërshtimit të kontrolleve në gjykatë dhe e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, prandaj në vijim do të analizojë pretendimet në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e ankimit.

14. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

15. Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Ndërsa neni 43 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, për

kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset vetëm me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njih, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës (*shih vendimin nr. 9, datë 23.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Rregullat e ankimit në procesin penal janë detajuar në pjesën e dytë të KPP-së, Titulli VIII, nenet 407 – 421. Kështu në nenin 407 parashikohet se ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit (*pika 1*); ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit (*pika 2*); mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim (*pika 3*); e drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njih shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre (*pika 4*). Neni 420, po aty ka parashikuar shkaqet e mospranimit të ankimit, një prej të cilave është rasti kur vendimi është i paankimueshëm (*pika 1, shkronja “b”*). Ndërsa neni 202/a i KPP-së, që rregullon vendimin për lejimin e kontrollit, ka parashikuar se gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomën e këshillimit brenda 24 orëve nga kërkesa e prokurorit për lejimin e kontrollit dhe se kundër vendimit që e refuzon kërkesën mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve, i cili shqyrtohet prej kësaj të fundit brenda 48 orëve nga marrja e akteve (*pika 3*).

18. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë vendosur me radhë mospranimin e ankimit ndaj vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për kontrollin vetjak dhe të banesës. Në ankimin kushtetues nuk rezulton që ata të kenë kundërshtuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka lejuar kontrollin dhe as dispozitat e KPP-së që rregullojnë procedurën e kontrollit. Me fjalë të tjera, kërkuesit nuk kanë kundërshtuar *per se* kontrollin e banesës, paprekshmëria e së cilës garantohet nga neni 37 i Kushtetutës dhe as kontrollin personal, por kanë zgjedhur të kundërshtojnë vendimet gjyqësore që nuk kanë pranuar ankimet e tyre (apelin dhe rekursin).

19. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, duke interpretuar nenet 202 e vijues, 407 dhe 420 të KPP-së, kanë vlerësuar se ligji nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të kontrollit, ndaj vendimi i kontrollit është i paankimueshëm. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 207, pika 4, të KPP-së, kur kontrolli rezulton me

sekuestrim të provave materiale, vendimi i sekuestrimit është i ankimueshëm dhe i interesuari ka mundësi t'i paraqesë në aktin e ankimit të vendimit të sekuestrimit, pretendimet eventuale për procedurën e kontrollit. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kufizimi me ligj i sëdrejtës së ankimit për vendimin e kontrollit është i justifikuar nga urgjenca e veprimeve në fazën e hetimeve paraprake dhe qëllimi i kontrollit për gjetjen dhe sekuestrimin e provave materiale. Nëse do të vazhdohej procedura e ankimit do të humbiste qëllimi i kontrollit, i cili është në shërbim të prokurorisë, për të kryer hetime sa më të shpejta. Ky parashikim, në kuadër të rolit që ka organi procedues në këtë fazë është i nevojshëm për të gjitha palët, qoftë edhe në detyrën e prokurorit, i cili përveçse duhet të mbledhë prova për vërtetimin e akuzës ndaj të pandehurit, ka edhe detyrimin të marrë prova që vërtetojnëpafajësinë e tij (*shih paragrafët 27 dhe 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se KPP-ja ka parashikuar në mënyrë të shprehur se kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për kontroll mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatë brenda 24 orëve, ndërsa për vendimin që e lejon kontrollin nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit. Në këtë kuptim, është i arsyeshëm interpretimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm se kur ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit, afatet dhe/apo subjektet të cilat mund ta ushtrojnë atë, atëherë vendimi është i paankimueshëm. Kjo do të thotë se kufizimi i së drejtës së ankimit të kërkuesve në një gjykatë më të lartë është rrjedhojë e interpretimit të ligjit, për të cilin në jurisprudencë konstante kushtetuese është pohuar se i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë12.07.2023; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se, siç është shprehur Gjykata e Lartë, kur organi procedues nga kontrolli personal dhe i vendeve sekuestron prova materiale, atëherë pretendimet për procedurën e kontrollit paraqiten nga i interesuari në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykatë më të lartë. Duke vijuar këtë analizë, rezulton se në rastin kur nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe se të interesuarit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherëai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual. Ky i fundit, pas reformës kushtetuese të vitit 2016, që ka zgjeruar juridiksionin e Gjykatës për shqyrtimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore, përbën mjetin efektiv në dispozicion të individit sipas nenit 13 të KEDNJ-së, duke garantuar në këtë mënyrëaksesin dhe ankimin substancial në gjykatë.

22. Nën dritën e kësaj analize, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se interpretimi i dispozitave procedurale penale nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë në rastin e kërkuësve është i arsyeshëm dhe nuk biendesh me frymën e ligjit. Në këtë pikë, Mbledhja e Gjyqtarëve rithekson se nuk është detyrë e saj të interpretojë ligjin për qëllime të procesit gjyqësor që zhvillohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pasi ajonuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt. Interpretimi i ligjit në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihet në dyshim, përveç rasteve kur ai është arbitrar ose i paarsyeshëm, në kuptimin kur gabimi ligjor i gjykatës së juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se interpretimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm që t'iu ketë cenuar kërkuësve të drejtat e aksesit dhe të ankimit efektiv.

23. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konkludonse pretendimet e kërkuësve se vendimet gjyqësore të kundërshtuara u kanë cenuar të drejtat e aksesit dhe të ankimit efektiv janë haptazi të pabazuara.

24. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësonse ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga kërkuësit Arben Ahmetaj dhe Erjola Hoxha jam kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësoj se çështja duhej të kishte kaluar

për shqyrtim në seancë plenare, me qëllim shqyrtimin e pajtueshmërisë së nenit 202/a të KPP-së me nenin 43 të Kushtetutës, në interpretim të të cilit gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë dhënë vendimet objekt kundërshtimi.

2. Paraprakisht, theksoj se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës dhe neneve 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, individi legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për të kundërshtuar dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave gjykatat kanë disponuar vendime që i kufizojnë atij të drejta kushtetuese, sikurse ka ndodhur edhe në rastin në shqyrtim.

3. Konkretisht, ka rezultuar se Prokuroria e Posaçme, pas kryerjes së një sërë veprimeve hetimore paraprake, bazuar, ndër të tjera, edhe në kallëzimin penal të paraqitur nga një gazetar ndaj kërkuesit të parë, si dhe pas ndarjeve e bashkimeve të disa procedimeve penale, ka regjistruar në përfundim procedimin penal nr. 277/1/2023 për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP-së. Në vijim, ajo ka paraqitur kërkesë në gjykatë për kontrollin personal dhe të banesës së kërkueses së dytë, e cila, sipas prokurorisë, së bashku me kërkuesin e parë janë prindër të një fëmije. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 08.03.2023, e ka pranuar kërkesën dhe ka lejuar kontrollin personal dhe të banesës së kërkueses së dytë, sipas dispozitave dhe garancive të parashikuara në KPP, si dhe ka disponuar moslejimin e ankimit kundër vendimit. Më tej, GJKKO e Apelit, me urdhrin e datës 28.03.2023 dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 11.05.2023, nuk kanë pranuar as ankimin, as rekursin e kërkuesve, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar është i paankimueshëm, pasi KPP-ja nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit që lejon kontrollin e personave dhe të vendeve.

4. Në datën 11.09.2023, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për akses dhe ankimit efektiv, pasi gjykatat kanë kufizuar ushtrimin e së drejtës së ankimit para një gjykate më të lartë, ndaj një vendimi që u ka shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.

5. Shumica ka vlerësuar se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore që nuk kanë pranuar apelin dhe rekursin dhe nuk kanë kundërshtuar vendimin gjyqësor që ka lejuar kontrollin personal dhe të banesës, paprekshmëria e së cilës garantohet nga neni 37 i Kushtetutës, dhe as dispozitat e KPP-së që rregullojnë procedurën e kontrollit (*shih paragrafin 18 të vendimit*). Sipas shumicës, KPP-ja ka parashikuar në mënyrë të shprehur se kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për kontroll mund të bëhet ankim i veçantë, ndërsa për vendimin që e lejon kontrollin

nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit, për rrjedhojë interpretimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm se kur ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit, afatet dhe/apo subjektet të cilat mund ta ushtrojnë atë, vendimi është i paankimueshëm, është i arsyeshëm (*shih paragrafin 20 po aty*). Në përfundim, shumica ka çmuar se interpretimi i dispozitave procedurale penale nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm që t'iu ketë cenuar kërkuesve të drejtat e aksesit dhe të ankimit efektiv (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

6. Për sa më lart, unë, gjyqtarja në pakicë, ndaj qëndrim të ndryshëm lidhur me vlerësimin e shumicës, pasi çmoj se në rastin e kërkuesve kriteret paraprake, përfshirë edhe atë *rationemateriae*, *prima facie* duket të jenë plotësuar dhe bazueshmëria në themel e kërkesës duhej të shqyrtohej në seancë plenare, pasi edhe pse formalisht në objektin e ankimit kushtetues të tyre kërkuesit nuk kanë kërkuar kontrollin e nenit 202/a të KPP-së, në thelb të pretendimeve ata i referohen cenimit të së drejtës së ankimit efektiv dhe aksesit që rrjedh jo nga zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por pikërisht si pasojë e parashikimeve të kësaj dispozite.

7. Në këtë pikë sjell në vëmendje se neni 71/b, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000, shtuar me ndryshimet e reja që solli reforma në drejtësi, ka zgjeruar mundësitë e Gjykatës, pasi tashmë ajo ka të drejtë që kur shqyrton kushtetutshmërinë e një akti (akt i pushtetit publik, vendim gjyqësor e akte të tjera) dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, të vendosë njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ. Mbështetur në interpretimin sistematik të kësaj dispozite, vlerësoj se edhe pse formalisht kërkuesit nuk e kanë ngritur kërkimin e tyre në objekt, pra në nivelin e një kërkitimi të mirëfilltë kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve, në zbatim të parimit *iuranovitcuria*, duhet të kishte shqyrtuar paraprakisht edhe këtë çështje dhe të kishte disponuar kalimin e saj në seancë plenare, me qëllim vlerësimin në themel të kushtetutshmërisë së normës konkrete ligjore që aplikohej në rastin e kërkuesit(ve).

8. Në këtë këndvështrim, çmoj se e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, është e parashikuar në mënyrë taksative dhe ekskluzive në një dispozitë të posaçme të Kushtetutës. Neni 43 i Kushtetutës i garanton kujtdo ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç dy rasteve specifike të përcaktuara në mënyrë shteruese në përmbajtje të saj, kur (i) parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative dhe (ii) për çështje me rëndësi ose vlerë të vogël, në

përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se përcaktimin nëse ndaj një

vendimi gjyqësor lejohet apo jo ankimit në një gjykatë më të lartë e bën Kushtetuta dhe Gjykata, si interpretuese në vetë të parë e saj ka detyrimin të interpretojë dispozitën kushtetuese që lejon ose ndalon, sipas rastit, ushtrimin e një të drejte kushtetuese, sikurse të drejtën e ankimit. Ndërsa, interpretimi i dispozitave ligjore, sikurse e pranon edhe vetë shumica, është në tagrin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

9. Ky qëndrim imi mbështet në jurisprudencën e konsoliduar kushtetuese, e cila ka theksuar se interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 29, datë 30.06.2011; nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Nga ana tjetër, sjell në vëmendje se Gjykata në mënyrë të vazhdueshme është shprehur se me Kushtetutë kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial (*shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023; nr. 2, datë 18.01.2017; nr. 24, datë 25.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nën këtë optikë vlerësoj se, në thelb, pretendimet e kërkuësve kishin të bënin me interpretimin e nenit 43 të Kushtetutës në raport me dispozitat procedurale penale të zbatueshme nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, parashikimet e të cilave kërkuësve iu ka kufizuar të drejtën kushtetuese të ankimit e lidhur edhe me të drejtën e aksesit, ku si rezultat fundor atyre u ishin cenuar disa të drejta kushtetuese, përfshirë edhe paprekshmërinë e banesës, të garantuar nga neni 37 i Kushtetutës, referuar pretendimeve të tyre në ankimit.

12. Në këtë pikë theksoj se kur parashikimi i një norme ligjore dhe zbatimi i saj nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mund të cenojë të drejtat kushtetuese dhe duke mbajtur në konsideratë se Gjykata, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti, atëherë çështja duhet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues për të vlerësuar nëse norma ligjore mbi bazën e të cilës është disponuar prej tyre mospranimi i mjeteve të ankimit është apo jo në pajtueshmëri me Kushtetutën.

13. Për të gjitha argumentet e mësipërme, çmoj se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesit duhet të kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare.

Anëtare: Sonila Bejtja